I Dërguari i Allahut ﷺ e pëlqente lutjen gjithëpërfshirëse dhe e linte mënjanë çdo gjë tjetër

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton: "I Dërguari i Allahut ﷺ e pëlqente lutjen gjithëpërfshirëse dhe e linte mënjanë çdo gjë tjetër."

[Sahih] [Transmetojnë Ebu Davudi dhe Ahmedi]

Profeti ﷺ i pëlqente lutjet gjithëpërfshirëse, që përfshijnë të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, me pak fjalë, por me kuptime të thella, që përmbajnë lavdërimin e Allahut të Lartësuar dhe qëllime fisnike, dhe linte mënjanë çdo gjë tjetër.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5886